



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 24 Janar 2022

Nr: 7

V E N D I M

P Ë R

**SHPLLJEN E REZULTATIT TË SHORTIT PËR CAKTIMIN E PARTIVE QË DO TË PROPOZOJNË ANËTARIN E SHTATË TË KZAZ-VE, PËR ZGJEDHJET E PJESSHME VENDORE PËR KRYETAR BASHKIE NË BASHKITË SHKODËR, DIBËR, DURRËS, VORË, RROGOZHINË DHE LUSHNJE TË DATËS 6 MARS 2022**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n”, dhe 2, nenit 29, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 4 të vendimit nr. 5, datë 20.11.2020 të Komisionit Rregullator “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V Ë R E N:

Në mbështetje të nenit 29, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, përcaktohet se anëtari i shtatë propozohet në gjysmën e KZAZ-ve nga partia e parë e shumicës parlamentare, kurse në gjysmën tjetër nga partia e parë e opozitës parlamentare, sipas kriterëve objektive të bazuara në:

- i. përzgjedhjen rastësore;
- ii. shpërndarjen e barabartë në territorin zgjedhor.

Komisioni Rregullator, për zbatimin e kriterëve ligjore të sipërcituara, me vendimin nr. 5, datë 20.11.2020 “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor”, në nenin 4 të tij përcakton procedurat për organizimin në seancë publike të hedhjes së shortit nëpërmjet partisë së parë të shumicës parlamentare dhe partisë së parë të opozitës parlamentare. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve shpall me vendim rezultatin e shortit.



Data: 24 Janar 2022

Nr.

“Për shpalljen e rezultatit të shortit për caktimin e partive që do të propozojnë anëtarin e shtatë të KZAZ-ve, për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie në bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnje të datës 6 Mars 2022”

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 5, datë 24.01.2022 “Për përcaktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarët dhe sekretarët e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie në bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnje, të datës 6 Mars 2022”, ka përcaktuar se anëtari i shtatë do të propozohet në gjysmën e KZAZ-ve nga Partia Socialiste e Shqipërisë, parti e parë e shumicës parlamentare, kurse në gjysmën tjetër të KZAZ-ve nga Partia Demokratike, parti e parë e opozitës parlamentare, sipas rezultatit të shortit që do të hidhet në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, më datë 24.01.2022, ora 13:30, në seancë publike organizoi hedhjen e shortit nëpërmjet Partisë Socialiste të Shqipërisë dhe Partisë Demokratike, sipas procedurës së përcaktuar në nenin 4, të vendimit nr. 5, datë 20.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor”.

Shorti që do të hidhet për caktimin e partisë politike që do të propozojë anëtarin e shtatë të KZAZ-ve, do të përfshijë 13 (trembëdhjetë) KZAZ, konkretisht:

- a) Bashkia Shkodër përfshin katër Zona të Administrimit Zgjedhor (ZAZ 2,3,4,5);
- b) Bashkia Dibër përfshin një Zonë të Administrimit Zgjedhor (ZAZ 19);
- c) Bashkia Durrës përfshin katër Zona të Administrimit Zgjedhor (ZAZ 21, 22, 23, 24);
- d) Bashkia Vorë përfshin një Zonë të Administrimit Zgjedhor (ZAZ 26);
- e) Bashkia Rrogozhinë përfshin një Zonë të Administrimit Zgjedhor (ZAZ 43);
- f) Bashkia Lushnje përfshin dy Zona të Administrimit Zgjedhor ( ZAZ 54, 55).

Kriteri i përcaktuar në nënparagrafin “ii” të dispozitës së sipërcituar “shpërndarjen e barabartë në territorin zgjedhor”, mund të zbatohet në masën 100% në bashkitë Shkodër, Durrës dhe Lushnje ku numri i KZAZ-ve tek dhe çift është i barabartë, ndërsa për Bashkitë Dibër, Vorë dhe Rrogozhinë nuk mund zbatohet në masën 100%, pasi këto bashki kanë nga një ZAZ secila .

Në referim të nenit 4, pika 6, të vendimit nr. 5, datë 20.11.2020 të Komisionit Rregullator “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor”, procedura e shortit zhvillohet si vijon:

- Emrat e partive pjesëmarrëse në short shkruhen në shirita letre, të cilat mbyllen në dy gogla me formë, peshë dhe ngjyrë të njëjtë, të vendosura në një enë transparente;
- Dy shirita letre ku në shiritin e parë shkruhet “KZAZ-të e numërtuar me numër tek” dhe në shiritin tjetër “KZAZ-të e numërtuara me numër çift”, të cilat mbyllen në dy gogla me formë, peshë dhe ngjyrë të njëjtë, të vendosura në një enë transparente;



- Një nëpunës i administratës së KQZ-së tërheq një nga goglat që ndodhen në enën e parë;
- Përfaqësuesi i partisë, emri i së cilës u tërhoq nga ena e parë, tërheq i pari njërën nga dy goglat e enës së dytë;
- Partisë politike, përfaqësuesi i së cilës tërhoqi gogllën në enën e dytë, i lind e drejta të propozojë anëtarin e shtatë të KZAZ-ve, sipas përcaktimit në shiritin e letrës brenda gogllës së tërhequr.

Sipas rezultatit të shortit, Partia Socialiste e Shqipërisë do të propozojë anëtarin e shtatë të KZAZ-ve me numër tek dhe Partia Demokratike do të propozojë anëtarin e shtatë të KZAZ-ve me numër çift.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n”, dhe 2, nenin 29, pikat 1 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nenit 4 të vendimit nr. 5, datë 20.11.2020 të Komisionit Rregullator “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

### **V E N D O S I:**

1. Partia Socialiste e Shqipërisë do të propozojë anëtarin e shtatë të KZAZ-ve të renditura me numër tek, sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Partia Demokratike do të propozojë anëtarin e shtatë të KZAZ-ve të renditura me numër çift, sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare elektronike të KQZ.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 (njëzet e katër) orë ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**



Qarku	Bashkia	ZAZ Nr	Partia politike që propozon anëtarin e 7-të
Shkodër	SHKODËR	02	Partia Demokratike
		03	Partia Socialiste e Shqipërisë
		04	Partia Demokratike
		05	Partia Socialiste e Shqipërisë
Dibër	DIBËR	19	Partia Socialiste e Shqipërisë
Durrës	DURRËS	21	Partia Socialiste e Shqipërisë
		22	Partia Demokratike
		23	Partia Socialiste e Shqipërisë
		24	Partia Demokratike
Tiranë	VORË	26	Partia Demokratike
	RROGOZHINË	43	Partia Socialiste e Shqipërisë
Fier	LUSHNJE	54	Partia Demokratike
		55	Partia Socialiste e Shqipërisë